



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626/23/016/221

Në bazë të nenit 5 paragrafi 1 dhe nenit 108/A paragrafit 6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në bazë të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik nr. 60 paragrafi 60.1 pika b) dhe nenit 62 paragrafi 62.1 pika a) bie këtë :

## V E N D I M

I

**Refuzohet si e jashtë afatshme** kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik - “Gentian Sakaj” B.I. – Suharekë e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 29.09.2023 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-23-7240-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-016-2-2-1 me titull “SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS”

II

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.**

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik “Gentian Sakaj” B.I. nga Suhareka më datën 29.09.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin njoftim është përcaktuar përfituesi i tenderit me titull: “SERVISIMI, MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS”

Si autoritet kontraktues brenda afatit ligjor kemi filluar shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim. Duke analizuar të njëjtën kemi vërejtur se kërkesa për rishqyrtim rezulton të jetë dorëzuar jashtë

afatit të paraparë në nenin **60 paragrafi 60.1 pika b)** të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Zyra jonë me datë 29.08.2023 në platformën elektronike, ka publikuar njoftimin B58 mbi vendimin e Autoritetit kontraktues dhe letrat standarde. Sipas nenit **60 paragrafi 60.1 pika b)** të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, afati për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim është brenda 5 ditëve nga data e publikimit. Operatori Ekonomik e ka dorëzuar kërkesën pas publikimit të njoftimit B58 nga ana jonë, mirëpo e njëjta është dorëzuar tridhjetë (30) ditë pas datës së publikimit të vendimit B58.

LPP në nenin 5 paragrafi 1 shprehimisht e ka paraparë që: **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit.**

Ne si autoritet kontraktues nuk jemi lëshuar në shqyrtimin e përmbajtjes së ankesës, pasi që e njëjta është cilësuar si e jashtë afatshme dhe në përputhje me nenin 62 paragrafi 62.1 pika a) e njëjta duhet të refuzohet.

**Andaj,**

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në Mamushë, me dt. 02.10.2023

Gazmend Gashi  
Udhëheqësi i sektorit të Prokurimit  
Komuna e Mamushës



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.